



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC

Drejtoria për Arsimit

Odeljenje za Obrazovanje



Drejtoria Komunale e Arsimit

Odeljenje za Obrazovanje

Department of Education

- IV - Nr. i prot. 521 Më 07.10.2022
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Informatë e DKA-së për fillimin e Vitit të Ri Shkollor 2022/2023

Të nderuar!

Drejtoria Komunale e Arsimit gjatë gjithë muajit të fundit ka punuar dhe ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura për një fillim të mbarë të vitit të ri shkollor 2022/2023. Në muajin gusht, kemi analizuar me kujdesin më të madh gjendjen e personelit mësimor në të gjitha shkollat e komunës sonë, duke bërë një planifikim dhe një ri sistemim të kuadrit mësimor sipas profileve mësimore në të gjitha nivelet, duke filluar nga niveli parafillor e deri tek niveli i mesëm i lartë. Si rezultat i planifikimit të bërë, kemi patur edhe konkurse për plotësimin e vendeve të lira në disa pozicione në shkollat e komunës, shumica e të cilave ishin zëvendësime, pra pozita me kohë të caktuar.

Në fund të muajit gusht, nga Ministria e Arsimit kemi pranuar librat/tekstet shkollore për klasat 1 deri 9, të cilat fillimisht i kemi vendosur në pikën grumbulluese dhe pastaj ato i kemi shpërndarë në të gjitha shkollat fillore të komunës sonë. Vonesë për furnizimin me libra pati vetëm për ato të klasës së pestë, të cilat nuk u sollën nga MASHTI deri më 25 shtator 2022. Fillimi i Vitit të Ri Shkollor, fatkeqësisht edhe këtë vit nuk filloi më 1 shtator, për shkak të grevës së organizuar nga SBASHK-u dhe dhe BSPK-ja, që nga data 25 gusht 2022.

DKA ka grumbulluar të gjitha kërkesat e shkollave për lëndë djegëse që do të përdoren për ngrohje gjatë muajve të dimrit, dhe furnizimi me to do të fillojë së shpejti.

Kemi realizuar projektin e instalimit të ngrohjes qendrore në SHML „Xhelal Hajda-Toni“, ndërkohë që për shkak se në njërin objekt të Shfmu „Isa Boletini“ dhe në objektin e Shfmu „Bekim Sylka“ akoma nuk kanë përfunduar punimet në ndërmarrjen e masave të eficiencës së energjisë, nxënësit e këtyre dy shkollave mësimin po vazhdojnë ta vijnë përkatësisht në objektin e IAAP „Selajdin Mullabazi-Mici“ dhe në Shfmu „Sadedin Hajda“.

Punimet në eficiencë të energjisë po vazhdojnë edhe në SHML „12 Maji“ dhe në paralelen e ndarë të Shfmu „Skënder Kastrati“ në Gexhë. Këto punime po zhvillohen ngadalë.

Me keqardhje duhet t'ju themi se trendi i rënies së numrit të nxënësve edhe këtë vit është i madh. Zvogëlimi i numrit të nxënësve ka shkaktuar probleme sepse ka ndikuar edhe në zvogëlimin e numrit të klasave dhe për pasojë edhe zvogëlimin e normave të mësimdhënësve.

Ne kemi qenë dhe jemi vazhdimisht në kontakt të përhershëm dhe në vizita në shkolla dhe sipas të gjitha të dhënave që kemi, procesi mësimor ka filluar në të gjitha shkollat, por me vonesë prej 1 muaji, përkatësisht më 3 tetor 2022, pas pezullimit të grevës nga ana e sindikalistëve.

Drejtoria Komunale e Arsimit ka bërë gati një plan me një varg aktiviteteve dhe fillimisht kemi filluar vizitat e zyrtareve të DKA-së në të gjitha shkollat. Vizita të këtilla nëpër shkolla do të ketë vazhdimisht sepse synojmë që sistemin arsimor të komunës sonë ta ngrisin në një nivel më të lartë, që siguron arsim cilësor.

Datë: 07.10.2022



Avni Morina, Drejtor i DKA-së

Avni Morina